

Ermal Murati diplomuar në vitin 2001 në Administrim Biznesi, profili Marketing, është drejtues ekzekutiv dhe ekspert i menaxhimit të performancës me 20 vite eksperiencë në sektorët e ujit, energjisë dhe telekomunikacionit në Shqipëri. Gjatë karrierës së tij ka mbajtur pozicione të larta drejtuese dhe strategjike, duke kontribuar në forcimin e qeverisjes institucionale, përmirësimin operacional, analizën financiare, monitorimin e performancës dhe modernizimin e proceseve në sektorë të rregulluar dhe kritikë për shërbimet publike.

Së fundmi ka shërbyer si Adminsitrator I Shoqërise Rajonale të Ujesjellës Kanalizime Vlorë, ku ka drejtuar proceset e transformimit institucional, përmirësimit të performancës, standartizimit të proceseve dhe forcimit të mekanizave të raportimit dhe kontrollit.

Më parë ka shërbyer si Këshilltar pranë AKUK, Drejtori Ekonomik i OSHEE Group dhe Drejtor i Operacioneve Komeriale në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), me fokus të veçantë në sistemet e monitorimit të performancës, analizën e të dhënave, bilancin energjetik, menaxhimin financiar dhe optimizimin operacional.

Gjithashtu, ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Shërbimit ndaj Klientit në Albtelecom dhe Eagle Mobile, ku ka drejtuar transformimin e proceseve të shërbimit ndaj klientit, monitorimin e performancës operacionale, përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe optimizimin e proceseve të raportimit dhe analizës në sektorin e telekomunikacionit.

Ekspertiza e tij përfshin analizën financiare dhe operacionale, standardizimin e raportimit, qeverisjen e të dhënave, menaxhimin e riskut dhe mbështetjen e vendimmarrjes strategjike për institucione publike dhe ndërmarrje utilitare. Gjithashtu njihet për orientimin drejt reformave dhe aftësinë për të menaxhuar procese komplekse në ambiente shumëpalëshe dhe të rregulluara.